



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:000527

Datë: 30.11.2023

Numri i dokumentit: 04990204

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.20/2022

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnye në çështjen penale kundër të pandehurve E. B. dhe E. I. nga Peja, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1997/2021 të datës 05.01.2022, i pari për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, ndërsa i pandehuri i dytë për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 dhe nën par.1.4 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 27.11.2023, në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit E. B. dhe të pandehurit E. I., me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Gani Kelmendi, me datë 30.11.2023 mori, shpalli dhe përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

E. B., nga i ati A. dhe nëna M., e gjinisë R., i lindur me datë, në Pejë ku edhe banon në rrugën "D. Gj. L.", nr...., ka të kryer shkollën e mesme të arteve, i pa martuar, me profesion punëtor, me numër personal të identifikimit, egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

E. I., nga i ati R. dhe nëna S., i lindur me datë në Pejë, banon në rrugën " N. V.", nr.1, ka të kryer shkollën fillore, me profesion biznes familjar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të identifikimit, posedon numrin e telefonit 045/...-...., rom, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

SHPALLËN FAJTOR

Për shkak se :

I pandehuri E. B.

- Me dt. 31.08.2021, rreth orës 22:30 minuta, në rrugën " N. V." me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarit E. I., në atë mënyrë, që pas një zënke në mes të të dëmtuarit dhe të pandehurit pasi që ky i fundit i kishte shkruar në facebook motrës së tij, duke ju drejtuar me fjalët " Merima shpirti jem, të dua shumë", ashtu që përderisa i dëmtuari ishte duke qëndruar në ballkonin e shtëpisë, aty vije i pandehuri i cili e sulmon, duke shtyrë të dëmtuarin me duar dhe duke e goditur flakaresh, pasi që ky i fundit kishte dalë që të shikojë se kush kishte hyrë në oborr të shtëpisë,

-me çka ka kryer vepër penale Sulm nga neni 184 par 1 të KPRK-së

I pandehuri E. I.,

Me dt.31.08.2021, rreth orës 22:30 minuta, në rrugën " N. V." në Pejë, në shtëpinë e tij, me mjet të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit E. B. , në atë mënyrë që pas një zënke në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit dhe pasi që ky i fundit i kishte shkruar në facebook motrës së tij, duke ju drejtuar me fjalët " Merima shpirti jem, të dua shumë", ashtu që përderisa i pandehuri ishte duke qëndruar në ballkonin e shtëpisë së tij, aty vije i dëmtuari i cili pasi e shtynë me duar të pandehurin duke tentuar edhe ta grushtojë, i pandehuri merr një dru me të cilin e godet të dëmtuarin në pjesën e barkut dhe pjesë të tjera ku si pasojë e kësaj i shkakton kontusion në shuplakën e dorës së majtë, të shkaktuara nga ndonjë mjet i fortë dhe i rëndë mbretës, të cilat si të tilla paraqesin lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet.

- me çka ka kryer vepër penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së,

Prandaj në kuptim të nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit E. B. i shqipton:

- DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje prej një (6) gjashtë muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit E. I., i shqipton:

- DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vitesh, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Obligohen të dënuarit që secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej nga 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

ARSYETIM

Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 05.01.2022 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1997/2021 kundër të pandehurve E. B. dhe E. I. nga Peja, i pari për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, ndërsa i pandehuri i dytë për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 dhe nën par.1.4 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 27.11.2023, e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri E. B. dhe i pandehuri E. I., me mbrojtësin e tij të

caktuar sipas detyrës zyrtare av.Gani Kelmendi, në të cilën seancë të pandehurit u deklaruan se e pranojnë fajësinë për veprat penale që u vihen në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit, pasi që është e qartë se të pandehurit e kuptuan natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga të pandehurit, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi "Meqenëse të pandehurit e pranuan fajësinë konform kushteve ligjore të parapara me neni 242 të KPPRK-së dhe një gjë të tillë e bënë vullnetarisht dhe në mbështetje në faktet e çështjes, që përmban aktakuza, nga gjykata kërkoj që të akuzuarit në fjalë ti shpall fajtorë, ti dënoj sipas ligjit dhe ti obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese".

I pandehuri E., ka deklaruar" unë mendoj se E. nuk osht dasht me qenë fare këtu sot, ai që e meriton mu dënu jam unë, pasi që e kam sulmuar në shtëpi të veten, pa asnjë pikë faji, dhe më vjen shumë keq për sjelljen teme, në prezencë të gjykatës i kërkoj falje E.edhe pse e di që e ka të vështirë me ma fal."

Mbrojtësi i të pandehurit E. deklaroi:" Meqenëse i mbrojturi im e pranoj në mënyrë vullnetare fajësinë dhe është penduar për këtë rast, që është dashtë të ndërmarre ngase është sulmuar në shtëpinë e tij, gjithashtu gjykata të ketë parasysh se i njëjti ka kryer një vepër të parë dhe të mbramë, është penduar për rastin që ka ndodhur, prandaj kërkoj nga gjykata që të ketë parasysh këtë rrethanë".

I pandehuri E. deklaroi:" Krejt çka u tha sot në gjykatë janë sende të vërteta, e pranoj kërkim faljen prej E. dhe nuk kam çka të shtoj tjetër, nuk kemi pasur telashe më prej asaj kohe".

Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69, 70 dhe 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese te çështjes.

Për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor të pandehuri ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me burgim deri në tre (3) vjet përkatësisht deri ne pese vjet për te pandehurin E., e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit të parë vendosi qe të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej (6) gjashtë muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, qe do të llogaritët nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa për të pandehurin e dytë vendosi qe te shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 (vitesh) vitesh, që do të llogaritët nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurit si rrethana rënduese nuk gjeti, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit në seancën e shqyrtimit fillestar, keqardhjen e shfaqur nga të pandehurit me rastin e pranimit të fajësisë dhe faktit se te njëjtit nuk kanë pasur telashe nga koha e kryerjes së veprave penale. E duke u nisur nga këto rrethana, nga fakti se rrethanat lehtësuese mbi peshojnë ato renduese dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurve të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit te dënimit me burgim gjykata u bazua ne nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurve do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi qe ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurve, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurve se nëse në periudhën verifikuese të përcaktuar në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë

dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e ne këtë rast siç u përshkrua me lartë për veprat penale që janë shpallur fajtor të pandehurit është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim deri në tre (3) vite përkatësisht pesë (5) vite për të pandehurin E..

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurve është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.20/2022, me datë 30.11.2023

Procesmbajtësja:
Shpresa Kërnje

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.